

VENDIM
Nr. 624, datë 10.10.2024

PËR EKUIVALENTIMIN E GRADAVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË POLICISË SË SHTETIT, TË GARDËS SË REPUBLIKËS DHE TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN ME GRADAT E POLICISË SË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 8, të nenit 55, të ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, të ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekuivalentimin e gradave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas ligjit nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të Policisë së Shtetit, sipas ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, të Gardës së Republikës, sipas ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, sipas ligjit nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, me gradat e Policisë së Burgjeve, sipas ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Për ekuivalentimin me gradën “nënkomisar” pranë Policisë së Burgjeve, kandidati duhet të zotërojë një diplomë të arsimit të lartë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara dhe të akredituara sipas dispozitave në fuqi në kohën e lëshimit të diplomës ose të zotërojë një diplomë të të njëjtit cikël, të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, të njohur e të njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr.1

Tabela ekuivalentuese e gradave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin me gradat e Policisë së Burgjeve

Nr.	Emërtimet e gradave ushtarake, sipas ligjit nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar	Emërtimet e gradave të Policisë së Shtetit, sipas ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”	Emërtimet e gradave të punonjësve të Gardës së Republikës, sipas të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar	Emërtimet e gradave të Punonjësve MNZH - së, sipas ligjit nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”	Emërtimet e gradave të punonjësve të Policisë së Burgjeve, sipas ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar
1	Kolonel	Drejtues i Parë	Drejtues i Lartë/Drejtues i parë;	Drejtues Zjarrfikës	Drejtues i lartë
	N/Kolonel	Drejtues	Drejtues	Drejtues i Parë Zjarrfikës	Drejtues
2	Major	Kryekomisar	Kryekomisar	Komisar Zjarrfikës	Kryekomisar
3	Kapiten	Komisar	Komisar	K/Inspektor Zjarrfikës	Kryekomisar
4	Toger, N/Toger	Nënkomisar	Nënkomisar	Inspektor Zjarrfikës	Komisar
5	K/Kapter, Kapter	Inspektor	Inspektor i Parë	Kryezjarrfikës	Nënkomisar
6	Rreshter, Tetar, N/Tetar	Inspektor	Inspektor i Dytë	Zjarrfikës	Kryeinspektor
7	Ushtar (IV, III, II, I)	Inspektor	Inspektor	Asistent Zjarrfikës	Inspektor

